

20/05/2024

AKT THEMELIMI DHE STATUT: " EcoHub" SH.P.K

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " EcoHub" SH.P.K

STATUT
PER KRIJIMIN E PERSONIT JURIDIK, SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE
KUFIZUAR: "EcoHub" SH.P.K

Z. Klajdi COKA lindur me 31/05/1990 ne Durres, qytetar shqiptar, banues ne Tiranë, mbajtes I leternjoftimit me numër Personal J005310891, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

Znj. UENDA HUSHI, lindur me 26/05/1997 ne Manez, qytetar shqiptar, banues ne Durres, mbajtes I leternjoftimit me numër Personal J75526050W, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

Në mbështetje të dispozitave ligjore të Kodit Civil në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, vendosëm themelimin e Shoqërisë Tregtare "EcoHub" Sh.p.k., shoqëri private e së drejtës Shqiptare, krijimi, funksionimi I së cilës përcaktohet si më poshtë vijon:

KREU
EMRI I SHOQERISE, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI

NENI 1
EMERTIMI I SHOQERISE

- 1.1 Emri i shoqërisë me pergjegjësi së kufizuar është "EcoHub" SH.P.K (më poshtë e quajtur "Shoqëria"), person juridik privat I së drejtës Shqiptare, I themeluar dhe do të ushtrrojë veprimtarinë në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë. Kjo shoqëri në llojin e saj është Shoqëri me Përgjegjësi të kufizuara.
- 1.2 Veprimtaria dhe funksionimi I kësaj Shoqërie rregullohet sipas neneve të statutit të kësaj shoqërie dhe në përputhje me ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqitë Tregtare".

NENI 2
SELIA

- 2.1 DURRES Lagjja nr. 13, Rruga Plazhit, Perballe Shkembit te Kavajes, Objekt me nr. pasurie 58/33+1, Zona Kadastrale 8518 2504.
- 2.2 Asambleja e Pergjithshme mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Organi administrues i Shoqërisë mund të themelojë ose mbyllë dege dhe/ose zyra perfaqesimi, brenda apo jashte Republikës se Shqiperise.

NENI 3
VULA E SHOQERISE



AKT THEMELIMI DHE STATUT: "EcoHub" SH.P.K

3.1 Shoqëria ka vulën e saj, do të jetë si vijon: "EcoHub" SH.P.K.

3.2 Të gjitha Aktet dhe dokumentat që do të nxjerrë Shoqëria drejtuar palëve të treta dhe publikut duhet të tregojnë qartë dhe të lexueshëm emërtimin (Ilojin) e Shoqërise dhe pas emrit do të jenë tjalët "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara" ose shkurtimi sh.p.k. "EcoHub".

3.3 Shoqëria ka adresën e saj elektronike: ecohubalbania@gmail.com

3.4 Shoqëria ka nr. Kontakt të saj: **+355692365128**

NENI 4

OBJEKTI I SHOQERISE

- 4.1 Shoqëria ka për objekt te saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund te ushtrojë në bazë të legjisllacionit shqiptar, brënda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke u fokusuar në:
Grumbullimin, transportin edhe magazinimin mbetjeve, trajtimin e tyre per t'iu nenshtruar operacioneve te meparshme te rekuperimit si para-trajtimi, ndarja, fragmentizimi, ngjeshja, paletizimi, tharja, grirja, veshje e mbetjeve të ambalazheve/paketimeve në mënyrë që të ripërdoren. Magazinim, trajtim, riparim ose rinovim i mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike. Edukim, konsulence, trajnime, projekte në sektorin e mbrojtjes së mjedisit, specifikisht menaxhimit të mbetjeve dhe ekonomisë qarkulluese. Shoqëria gjithashtu do te zhvilloje cdo lloj aktiviteti konsulence, trajnime ne fushen e menaxhimit te informacione dhe/ose dokumentave te kompanive – prej letre ose ne forme elektronike. Shoqëria ofron sherbim ne shkaterrimin e dokumentacionit dhe informacionit konfidencial me ane te shkaterrimit, copezimit ose riciklimit te tyre. Shoqëria gjithashtu do te angazhohet ne qeradhenien e mjeteve dhe objekteve te ndryshme si pjese e aktivitetit te saj.
- 4.2 Për përmbushjen e objektit të saj Shoqëria:
- a) Mund të marrë pjesë dhe te jete e interesuar ne shoqeri dhe siper marrje, shqiptare apo te huaja, qe kryejne aktivite te njejta, te ngjashme apo te lidhura me aktivitetin e saj ose te subjekteve pjesemarrrese;
 - b) Mund të lidhë kontrata shitblerje, përdorimi, shkëmbimi, sipërmarrje apo marrëveshje të tjera me investitorë, bashkë investitorë, pronarë trualli apo objektesh, operatorë dhe administrues te strukturave turistike;
 - c) Mund te kryejë te gjithë veprimet e nevojshme ose të dobishme ose qe kanë të bëjnë, përfshirë por pa u kufizuar në ofrimin e garancive reale dhe/ose personale për detyrimet e veta dhe së të tretëve, veprime me pasuri të luajtshme, te paluajtshme, tregtare dhe cdo veprim tjetër që ka të bëjë me objektin e saj ose që mundëson një përdorim më të mirë të strukturave dhe/ose burimeve nëpërmjet shoqërive ose sipërmarrjeve në të cilat, direkt apo indirekt, Shoqëria ka pjesëmarrje apo kontrollin e tyre.
- 4.3 Shoqëria mund te veprojë ne Shqipëri dhe jashtë saj dhe te kryejë do aktivitet tjetër te lidhur, ndihmës me qëllim te përmbushje ose te jetë i dobishëm për përmbushjen e objektit te saj.

NENI 5



AKT THEMELIMI DHE STATUT: " EcoHub" SH.P.K
KOHEZGJATJA E SHOQERISE

- 5.1 Shoqëria do të zhvillojë Veprimtarinë e saj për një kohë pa afat.
5.2 Ajo mund të shpërndalet para afatit me vendim të Ortakut, ose per shperndarje e saj e percakton vetë legjislacioni ne fuqi.

KREU II

KAPITALI, KALIMI I KUOTAVE, ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

NENI 6
KAPITALI I SHOQERISE

- 6.1 Kapitali i Shoqërisë ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin dhënë nga cdo ortak në Shoqëri. Cdo Ortak zotëron një kuotë të vetme në Shoqëri. Bashkëzotëruesit e një kuote, sipas nenit 72, të këtij ligji, gëzojnë cilësinë si një ortak i vetëm.
- 6.2 Kapitali fillestar për ushtrimin e veprimtarisë së Shoqërisë është 10.000 (dhjetë mijë) Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve ne Kapitalin e Shoqërisë është në përputhje me kontributet e tij si më poshte:
1. **Klajdi COKA** lindur me 31/05/1990 ne Durrës, qytetar shqiptar, banues ne Tiranë, mbajtes I leternjoftimit me numër Personal J00531089I, Zotërues I një kuote me vlerë nominale 5,000 (dhjete mijë) lekë dhe përfaqëson 50% të Kapitalit Themeltar
 2. **UENDA HUSHI**, lindur me 26/05/1997 ne Manez, qytetar shqiptar, banues ne Durrës, mbajtes I leternjoftimit me numër Personal J75526050W, Zotërues I një kuote me vlerë nominale 5,000 (dhjete mijë) lekë dhe përfaqëson 50% të Kapitalit Themeltar
- Kapitali i Shoqërisë nënshkruhet menjëhere dhe do të paguhet nga ortakët 100 % (njëqind per qind) të kontributeve në kapitalin e shoqërisë.
- 6.3 Në rast zmadhimi apo zvogëlimi të kapitalit themeltar te Shoqërisë, ortakët do të kenë të drejtën e nënshkrimit të zmadhimit apo zvogëlimit të kapitalit në përpjesëtim të drejte me pjesëmarrjen që zotëron secili në kapitalin e Shoqërisë.

NENI 7
KALIMI I KUOTAVE ME TRASHËGIMI OSE SI PASOJE E FALIMENTIMIT

- 7.1 Në rast se një ortak, apo një bashkëzotërues i një kuote humb jetën, trashëgimtarët e tij do të jenë të vetmët persona, që do të njihet titulli mbi kuotën nga Shoqëria por asnjë nga këto parashikime nuk çliron përgjegjësitë e trashëgimtarëve nga cdo detyrim i mbartur nga kuota e zotëruar. Në rastin e vazhdimit te Shoqërisë me disa trashëgimtare të ortakut që ka humbur jetën, trashëgimtarët duhet te caktojnë një



AKT THEMELIMI DHE STATUT: " EcoHub" SH.P.K

përfaqësues të përbashkët.

- 7.2 Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e humbjes së jetës ose falimentimit të një ortakut mund të zgjedhë të behet zoterues i kuotes ose të kerkojë regjistrimin e kuotes në emër të një personi tjetër të caktuar prej tij si perfitues i kuotes . Nëse personi i mesiperm zgjedh të behet zoterues i kuotes, ai njofton Shoqerine në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse personi i mesiperm zgjedh të kerkojë regjistrimin e kuotes në emër të një personi tjetër atëherë ai duhet ta kryejë atë nepërmjet një akti të vlefshëm të transferimit të kuotes.
- 7.3 Personi që fiton të drejtat mbi një kuotë si pasojë e humbjes së jetës ose falimentimit të një ortakut do të ketë të drejtat që gezonte zoteruesi i kuotes, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në do mbledhje të Asamblese së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit në regjistrin tregtar si zoterues i kuotes.

NENI 8

ZMADHIMI I KAPITALIT

- 8.1 Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë kapitalin e Shoqerisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 9.12 të këtij Akti Themelimi dhe Statuti. Vendimi i Asamblese së Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit do t'i komunikohet me shkrim ortakëve që janë thirrur por nuk ishin të pranishëm në mbledhjen e Asamblese së Përgjithshme që vendosi për zmadhimin e kapitalit.
- 8.2 Në rast zmadhimi të kapitalit, të gjithë ortakët do të kenë të drejtën të nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit, në para ose me kontribute në natyrë, në përpjesëtim të drejtë me kuotat që zoterojnë në Shoqëri.
- 8.3 Në rast se disa ortakë heqin dorë nga e drejta e nënshkrimit të pjesës së tyre, kapitali i panëshkruar mund të nënshkruhet nga ortakët e tjerë . Në këtë rast, këta ortakë mund të ushtrojnë serish të drejtën për nënshkrimin e kapitalit, në përpjesëtim të drejtë me kuotat e pjesëmarrjes në Shoqëri.

NENI 9

ZVOGELIMI KAPITALIT

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme mund të zvogelojë kapitalin e Shoqerisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 9.12 të këtij Akti Themelimi dhe Statuti. Në do rast, kapitali i Shoqerisë nuk mund të zvogelohet në kufirin e përcaktuar me ligj.
- 9.2 Ortakët e përballojnë zvogelimin e kapitalit të Shoqerisë, në përpjesëtim të drejtë me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqerisë.

KREU III

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME NENI 10 ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

- 10.1 Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi të gjitha çështjet për të cilat është kompetente sipas ligjeve në



AKT THEMELIMI DHE STATUT: "EcoHub" SH.P.K

fuqi ne Republikën e Shqipërisë, sipas ketij Akt Themelimi dhe Statuti dhe/ose do marrëveshje midis ortakëve të Shoqërisë.

- 10.2 Cdo ortak ka te drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehe vullnetin e tij si dhe te votojë në përputhje me pjesët e kapitalit qe ai zotëron ne Shoqëri.
- 10.3 Cdo ortak mund te perfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga nje perfaqesues i deleguar me prokure me shkrim.
- 10.4 Ortaku nuk mund të delegojë te drejtën e votes per nje pjesë te kuotave te tij te kapitalit, nese ai voton personalisht per pjesën e mbetur.
- 10.5 Mbledhja e Asamblesë se Përgjithshme mund te mbahet brënda ose jashtë territorit te Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose perfaqesuesit e autorizuar mund te marrin pjese ne mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nepermjet mjeteve elektronike, perfshire telekonferencen (*conference call*) audio ose video, ne perputhje me legjislacionin per shoqerite tregtare dhe komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme dote quhet e mbajtur ne vendin ku ndodhet Kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qellim qe te hartohet dhe te nenshkruhet procesverbal i perkates.
- 10.6 Asambleja e Përgjithshme mund te thirret nga Administratori/et ose nga ortakët që perfaqesojne te pakten 5% te kapitalit te Shoqerise. Thirrja e mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme duhet te behët nepermjet njoftimit me shkrim ose me mjete elektronike, derguar secilit prej ortakeve ne adresat e njoftuara Shoqerise, te pakten 15 (pesembedhjete) dite perpara dates se caktuar per mbledhjen e saj. Njoftimi duhet te permbaje rendin e dites, vendin, daten dhe oren e mbledhjes.
- 10.7 Asambleja e Përgjithshme do të mblidhet rregullisht, pavaresisht nga keto formalitete, ne rast se te gjithë ortakët apo perfaqesuesit e tyre jane te pranishem dhe bien dakord per rendin e dites.
- 10.8 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Administratori/ët. Asambleja e Pergjithshme cakton nje sekretar per do mbledhje midis personave te pranishem.
- 10.9 Vendimet e Asamblese së Përgjithshme duhet te jene me shkrim dhe te firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kerkese te ortakeve, vendimet duhet te perfshijne dhe deklaratat apo verejtjet e tyre.
- 10.10 Asambleja e Pergjithshme mblidhet te pakten nje here ne vit, brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit financiar.
- 10.11 Asambleja e Përgjithshme, në rastin e vendimeve që kërkojnë shumicën e zakonshme, merr vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote ose perfaqesuesit e tyre, qe zotërojnë me shumë se 30% (tridhjetë per qind) te kapitalit të Shoqërisë, perve rasteve te parashikuara me poshtë në nenin 9.12. Ne rast se ky kuorum nuk arrihet, Asambleja e Përgjithshme thirret në një mbledhje te dyte brënda 30 (tridhjetë) ditëve nga mbledhja e parë.
- 10.12 Asambleja e Pergjithshme vendos me votat pro te ¾ te ortakeve pjesëmarrës apo të perfaqesuar qe zotërojnë me shume se 50% të kapitalit te Shoqërise për ndryshimin e ketij Akt Themelimi dhe Statuti, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit te Shoqërise, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

KREU IV ADMINISTRIMI I SHOQERISE



AKT THEMELIMI DHE STATUT: " EcoHub" SH.P.K

NENI 11

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

- 11.1 Shoqëria administrohet nga një apo më shumë Administratorë të cilët zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë prej; **3 (tre) vjetësh**. **Administratori mund të rizgjidhet dhe shkarkohet në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme.**
- 11.2 Administratori zotëron kompetenca të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha aktet që konsideron të nevojshme për realizimin e objektivit të Shoqërisë, përveç; atyre që ligji apo ky Akt Themelimi dhe Statuti ia rezervon Asamblese së Përgjithshme apo organeve të tjera të Shoqërisë.
- 11.3 Administratori vepron në përputhje me politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë. Administratori mund të delegojë persona të tretë për kryerjen e veprimeve dhe akteve që kanë të bëjnë me administrimin e Shoqërisë, duke mbajtur përgjegjësi për të gjitha veprimet e kryera nga të tretet e deleguar për administrimin e Shoqërisë.
- 11.4 Administratori do të veprojë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë. Në rast konflikti të interesit, Administratori do të njoftojë menjëherë ortaket si dhe do të heqë dorë nga çdo veprim që lidhet me objektin e konfliktit të interesit deri në marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.
- 11.5 **Administratori i parë i Shoqërisë do të jetë :**

Klajdi COKA lindur më 31/05/1990 në Durrës, qytetar shqiptar, banues në Tiranë, mbajtes i leternjoftimit me numër Personal J00531089I, me zotësi të plote për të vepruar.

NENI 12

SHPERBLIMI I ADMINISTRATORIT

- 12.1 Asambleja e Përgjithshme përcakton shpërblimin e Administratorit të Shoqërisë.


NENI 13

PERFUNDIMI I DETYRES SE ADMINISTRATORIT

- 13.1 Detyra e Administratorit përfundon në rast se:
- (a) i përfundon mandati;
 - (b) shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme;
 - (c) jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar Shoqërinë;
 - (d) personi nuk gëzon cilesinë e Administratorit sipas parashikimeve të ligjit;
 - (e) mungon pa arsye në detyrë për më shumë se 6 (gjashtë) muaj radhazi dhe Asambleja e Përgjithshme vendos ta shkarkojë nga detyra.

KREU V

KONTROLLI FINANCIAR I SHOQERISE,
VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, DIVIDENDI



AKT THEMELIMI DHE STATUT: " EcoHub" SH.P.K

**NENI 14
KONTROLI FINANCIAR**

14.1 Kontrolli financiar i Shoqërise kryhet në përputhje dhe sipas legjislationit shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo më shumë Eksperte Kontabel të Autorizuar në ato raste kur emrimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

**NENI 15
VITI FINANCIAR**

15.1 Viti Financiar i Shoqërise fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

**NENI 16
BILANCI VJETOR**

16.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorit dhe të Ekspertit Kontabel të Autorizuar (nese janë emruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori i paraqet për miratim Asamblese së Përgjithshme raportin mbi administrimin e Shoqërise si edhe llogaritë vjetore.

16.2 Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

**NENI 17
DIVIDENDI**

17.1 Pasi të jenë përmbushur kërkesat e përcaktuara nga Ligji për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, Shoqëria, me shumicë të kualifikuar të votave së Asamblese së Përgjithshme, mund të vendosë shpërndarjen e dividendeve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

17.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që i bashkëngjiten kuotave, të gjithë dividendet duhet të deklarohen dhe paguhen sipas shumave të paguara në kuotat në të cilat paguhet dividendi. Të gjitha dividendet do të shpërndahen dhe paguhen në mënyrë proporcionale me shumën e paguara mbi kuotat gjatë do pjesë ose pjesëve të periudhës në të cilën paguhet dividendi.



AKT THEMELIMI DHE STATUT "EcoHub" SH.P.K

**KREU VI
PRISHJA DHE LIKUIDIMI, LIGJI I ZBATUESHEM,
ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE**

**NENI 18
PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE**

18.1 Ne rastin e prishjes dhe likuidimit te Shoqerise do te zbatohen dispozitat e parashikuara ne ligjin per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare.

**NENI 19
LIGJI I ZBATUESHEM**

19.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plate me kete Akt Themelimi e Statut dhe ligjin shqiptar. Per sa nuk eshte parashikuar ne kete akt, do te zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fushen e shoqerive tregtare.

**NENI 20
ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE**

20.1 Mos marrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqerise dhe ortakeve, apo ndermjet ortakeve dhe trashegimtareve te ortakeve ose ortakeve te tjere dhe/ose Shoqerise, qe kane per objekt te drejta te lidhura me Shoqerine, do te zgjidhen miqesisht ndermjet paleve te interesuara. Ne rast se palet nuk arrijne nje zgjidhje miqesore, Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tiranë do te jete kompetente per zgjidhjen e mosmarreveshjeve.

Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nenshkruhet ne 3 (tre) kopje ne gjuhen shqipe:

ORTAKET E SHOQERISE: "EcoHub" SH.P.K.

Klajdi Coka

Klajdi Coka



Uenda Hushi

Uenda Hushi

